




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

I. PROGRAMET E BASHKËPUNIMIT TERRITORIAL 2014-2020

Të përgjithshme

Sikurse përcaktohet në Rregulloren e Komisionit Evropian 231/2014 (Rregullorja IPA), *bashkëpunimi territorial* është një nga 5 fushat e politikave (*policy areas*) të Instrumentit IPA. Kjo fushë politikash konkretizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së vendeve IPA në programe të ndryshme që financohen nga Bashkimi Evropian. Aktualisht IPA është në periudhën e saj të dytë 2014-2020 dhe njihet si IPA II¹. Në këtë periudhë zbatuese Shqipëria merr pjesë në 8 Programe të bashkëpunimit territorial, si më poshtë:

- 4 programe dy-palëshe:
 - a) Interreg² IPA CBC³ Greqi-Shqipëri 2014-2020
 - b) IPA CBC Maqedoni – Shqipëri 2014-2020
 - c) IPA CBC Mali i Zi – Shqipëri 2014-2020
 - d) IPA CBC Shqipëri – Kosovë 2014-2020
- 1 Program tri-palësh:
 - a) Interreg IPA CBC Itali – Shqipëri – Mali i Zi 2014-2020
- 3 Programe Transnacionale⁴
 - a) Interreg ADRION (Adriatiko-Jonian)
 - b) Interreg Mediterranean (Mesdheu)
 - c) Interreg BalkanMed (Ballkan-Mesdheu)



¹ IPA I ka qënë e shtrirë në vitet 2007-2013.

² Interreg qëndron për **Inter-Regional**, i cili është një instrument financiar për vendet anëtare të BE (fondet ERDF). Programet në të cilat merr pjesë një vend anëtar i BE, krahas IPA mbajnë edhe emërtesën Interreg.

³ CBC qëndron për **Cross Border Cooperation**.

⁴ Në Programet Transnacionale zakonisht marrin pjesë më shumë se 5 vende (vende anëtare të BE si edhe vende jo-anëtare).

Hartimi: Ndryshe nga Programet Kombëtare të IPA-s, Programet e Bashkëpunimit Territorial hartohen një herë në 7 vite. Secili Program ka Dokumentin e tij Operacional, një material voluminoz në të cilin përcaktohen zonat e lejueshme ku mund të zbatohen projektet (Qarqet), prioritetet për financim, buxhetin total të Programit, strukturat menaxhuese të Programit, përfituesit (aplikantët) e mundshëm, metodologjia e zbatimit të projekteve, etj.

Zbatimi: Secili Program i perspektivës aktuale, është hartuar në fillim të periudhës IPA II, gjatë viteve 2014, 2015 dhe ato implementohen nëpërmjet lançimit të thirrjeve për projekt-propozime sipas prioriteteve përkatëse deri në fund të vitit 2023⁵. Secili Program ka strukturat e tij që lehtësojnë zbatimin. Një nga strukturat që kujdeset për zbatimin ditë pas dite të Programit është **Sekretariati Teknik**, një strukturë me staf të dedikuar. Struktura më e rëndësishme e Programeve të Bashkëpunimit Territorial është **Komiteti i Monitorimit** në të cilin secili vend pjesëmarrës përcakton *përfaqësuesit e tij*. Ky komitet *ad-hoc* në shumicën e Programeve ka kompetencë të miratojë listën e projekteve fituese.

Aplikantët/përfituesit e mundshëm: Entitetet që kryesisht mund të aplikojnë dhe zbatojnë projekte në kuadër të Programeve të Bashkëpunimit Territorial janë njësitë e qeverisjes vendore (Bashkitë, Qarqet, Agjensitë e Zhvillimit Rajonal), agjenci shtetërore, Drejtori Rajonale, organizata të shoqërisë civile (OJF, Qendra, Fondazione) Universitete, Qendra Kërkimore, si edhe institucione qëndrore (Ministri) në një numër më të vogël. Në mënyrë që këto entitete të përfitojnë mbështetje financiare nga Programet në fjalë, ato duhet të bëjnë partneritet me partnerë nga vendet e tjera pjesëmarrëse në Program dhe duhet të propozojnë projekte të përbashkëta. Është evidentuar se partnerë nga Shqipëria janë në një numër të lartë të përfshirë në projektet e bashkëpunimit territorial, krahasuar me vendet e tjera të Rajonit.

Marrëveshjet e Financimit: Për secilin Program të Bashkëpunimit Territorial nënshkruhet Marrëveshja përkatëse e Financimit mes Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, si edhe shtetit tjetër pjesëmarrës (në rastin e Programeve mes Shqipërisë dhe një vendi tjetër jo-anëtar të BE). Në rastin e Programeve me vende anëtare të BE, Marrëveshja e Financimit është shumëvjeçare dhe nënshkruhet mes Shqipërisë, KE dhe Autoritetit Menaxhues të Programit.

Forma e Donacionit: Kryesisht Projektet e bashkëpunimit territorial variojnë nga 250.000 – 1 milion Euro (për ato që njihen si projekte të zakonshme) dhe nga 1 Milion EUR në 5 Milion EUR (për projekte strategjike). Këto programe gjenerojnë kurdoherë vetëm grante, por me kusht që 85% e buxhetit total të secilit partner është financim i BE, ndërsa 15% është bashkëfinancim i vetë partnerit. Nuk ka në asnjë rast kredi.

Vizibiliteti: Në rastin e shpalljes së thirrjeve për projekt-propozime, gjithnjë njoftimi zyrtar shpallet në uebsite e institucionit që koordinon programin për Shqipërinë (MEPJ), më pas organizohen evente informues në zonat e lejueshme të Programit, shpërndahen broshura gjatë ditëve të informimit, bëhen njoftime me e-mail duke përdorur database që disponon Sektori përkatës, etj. Një informacion i tillë replikohet më pas edhe në uebsite të tjera që promovojnë


⁵ Programet e Bashkëpunimit Territorial funksionojnë sipas parimit *n+3*, që do të thotë se zbatimi i Programeve të periudhës 2014-2020, shtrihet deri në vitin 2023.

financimet e BE. Trajnime të dedikuara organizohen (sipas rastit) për të orientuar aplikantët e mundshëm mbi mënyrën e aplikimit, plotësimin të formateve të aplikimit, etj.

Hierarkia e Dokumentave të Punës (baza ligjore)



Arkitektura institucionale dhe organet menaxhuese për Programet e Bp. Territorial Interreg



Jashtë skemës hierarkike qëndrojnë strukturat e mëposhtme:

- Autoriteti i Auditit (dhe Grupi i Auditorëve)

- Autoriteti Certifikues (kryen pagesat për projektet, rimbursimet)

Kontributi dhe vlera e shtuar:

- Programet e Bashkëpunimit Territorial janë konsideruar nga vetë KE si një “akademi” në përgatitjen e vendeve kandidatë për të përthithur fondet ERDF (fondet e zhvillimit rajonal evropian) të cilat bëhen të aksesueshme pas anëtarësimit dhe kanë vlera shumë të mëdha. Pra, forcimi i kapaciteteve të administratës shqiptare në koordinimin e këtyre Programeve është vlerë e shtuar.
- Gjithashtu, për shkak të përfshirjes së gjerë të njësive të qeverisjes lokale si partnerë në këto projekte, kontribuohet tërthorazi në zbatimin e Reformës administrative-territoriale, duke i bërë bashkitë e vendit aktorë të rëndësishëm të zhvillimit territorial dhe jo të varura vetëm nga grantet e qeverisë;
- Në dritën e zhvillimeve të reja në rajon dhe rëndësisë që po merr gjithnjë e më tepër bashkëpunimi rajonal (Procesi i Berlinit, connectivity agenda) këto Programe po luajnë një rol pajtues mes vendeve pjesëmarrëse, përafrimi të standardeve dhe procedurave dhe po mundësojnë krijimin e një vizioni të ngjashëm për zhvillim mes vendeve rajonale.

II. INFORMACION PËRMBLEDHËS MBI PROGRAMET E BASHKËPUNIMIT TERRITORIAL 2014-2020

i. PROGRAMI: INTERREG IPA II CBC GREQI-SHQIPËRI 2014-2020

Zonat e lejueshme në Shqipëri: Zona ndërkufitare përfituese për pjesën e Shqipërisë përfshin: Qarkun e Vlorës, Qarkun e Gjirokastrës, Qarkun e Korçës dhe Qarkun e Beratit.

Buxheti Total i Programit: Totali **42,312,029 EUR**. Sipas informacioneve nga Autoriteti menaxhues Grek, me një vendim të Komisionit Evropian pritet që buxheti të shtohet me 5-7 Milion Euro. Vendimi është marrë në nivel ekzekutiv nga zyrtarët e KE, por ende nuk është formalizuar.

Prioritetet e Programit:

Aksi 1-Mbështetja e mjedisit, transportit të qëndrueshëm dhe infrastruktura publike

Aksi 2 - Nxitja e ekonomisë lokale

Autoriteti Menaxhues dhe Kontraktues: Autoriteti Menaxhues Grek në varësi të Ministrisë Greke të Ekonomisë.

Sekretariati Teknik (ST): është i vendosur në qytetin e Selanikut ku ndodhen edhe zyrat e Autoritetit Menaxhues. Programi ka edhe një Zyrë Mbështetëse (Antenë) në qytetin e Sarandës, me një person përgjegjës.

ii. PROGRAMI: IPA CBC MAQEDONI – SHQIPËRI 2014-2020

Zonat e lejueshme në Shqipëri: Qarku i Dibrës, Qarku i Elbasanit, Qarku i Korçës

Buxheti Total i Programit: 13,790,000 EUR

Prioritetet e Programit:

- Zhvillimi i potencialit të turizmit duke promovuar trashëgiminë dhe vlerat kulturore
- Forcimi i kapacitetit prodhues të SME-ve dhe qasja në tregje
- Nxitje e ndërgjegjësimit për një ekonomi të gjelbër, mjedis më të pastër dhe përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike

Autoriteti Kontraktues: Delegacioni i BE në Shkup

Sekretariati Teknik: ndodhet në Strugë ndërsa Zyra e Antenës (degë mbështetëse) është e vendosur në Elbasan.

iii. PROGRAMI: IPA CBC MALI I ZI - SHQIPËRI 2014-2020

Zonat e lejueshme në Shqipëri: Qarku i Shkodrës dhe Lezhës si edhe bashkia Tropojë

Buxheti Total i Programit: Totali **13,790,000 EUR** (bashkëfinancimi kombëtar 1,890,000 EUR, kontributi i BE 11,900,000EUR).

Prioritetet e Programit:

Aksi 1-Mbështetja e Turizmit, Kulturës dhe Trashëgimisë Natyrore;

Aksi 2–Mbrojtja e Mjedisit, adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi i rrisqeve dhe menaxhimi;

Aksi 3–Promovimi i punësimit dhe përfshirja sociale e kulturore.

Sekretariati Teknik: ndodhet në qytetin e Podgoricës. Programi ka edhe një Zyrë Mbështetëse (Antenë) në qytetin e Shkodrës.

iv. PROGRAMI: IPA II CBC SHQIPËRI-KOSOVË 2014-2020

Zonat e lejueshme në Shqipëri: Qarku Kukës dhe Qarku Lezhë

Buxheti Total i Programit: 9.734.118 euro

Prioritetet e këtij Programi, si më poshtë:

- Mbrojtja, ruajtja dhe vlerësimi i burimeve mjedisore

- Nxitje e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turizmi si një mundësi për zhvillimin ekonomik të zonës;
- Nxitja e integritit socio-ekonomik të të rinjve

Autoriteti Kontraktues: Delegacioni i BE në Tiranë

Sekretariati Teknik: ndodhet në Kukës. Zyra e Antenës (degë mbështetëse) është e vendosur në Prizren.

v. **PROGRAMI: INTERREG IPA CBC ITALI-SHQIPËRI-MALI I ZI 2014-2020**

Zonat e lejueshme: Shqipëria (i gjithë territori), Mali i Zi (i gjithë territori), Italia (Rajoni Puglia: Foggia, Bari, Lecce, Barletta-Andria-Trani and Taranto dhe Rajoni Molise: Isernia dhe Campobasso)

Buxheti Total i Programit: 93.000.000 Euro

Autoriteti Menaxhues dhe Kontraktues: Rajoni i Puglias, Itali.

Sekretariati Teknik: ndodhet në qytetin e Barit ku ndodhen edhe zyrat e Autoritetit Menaxhues. Sekretariati ka një Zyrë Kontakti në Tiranë dhe një në Mal të Zi (njihen si Pika Kombëtare të Kontaktit).

Prioritetet e Programit:

- Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe konkurrencës së SME-ve;
- Menaxhimi inteligjent i trashëgimisë kulturore dhe natyrore me qëllim nxitjen e turizmit;
- Mbrojtje e mjedisit, menaxhimi i riskut dhe strategjia e karbonit të ulët;
- Nxitje e aksesueshmërisë ndërkufitare, nxitja e transportit.

vi. **PROGRAMI: INTERREG MEDITERRANEAN (MED) 2014-2020**

Zonat e lejueshme:

Vendet e BE (instrumenti ERDF): Qipro; Franca; Greqia; Italia; Malta; Portugalia; Sllovenia; Spanja; Mbretëria e Bashkuar; Kroacia.

Vendet kandidate (Instrumenti IPA): Shqipëria; Bosnja dhe Hercegovina; Mali i Zi.

Buxheti Total i Programit: 233,678,791 EUR (nga të cilat IPA përafërsisht 9,3 milion Euro dhe ERDF përafërsisht 224,3 milion Euro).

Autoriteti Menaxhues dhe Kontraktues: Rajoni “Provence Alpes Cote d'Azur” (Francë)

Sekretariati Teknik: ndodhet në qytetin e Marsejës ku ndodhen edhe zyrat e Autoritetit Menaxhues. Nuk ka asnjë shqiptar në këtë Sekretariat.

Prioritetet e Programit:

- Promovimi i kapacitetit në inovacion;
- Efiçenca e energjisë;
- Nxitja dhe promovimi i kulturës dhe turizmit;

vii. PROGRAMI: INTERREG BALLKAN-MEDITERRAN 2014-2020

Zonat e lejueshme: 3 vende të BE: Greqia, Bullgaria, Qipro dhe **2 vende IPA:** Shqipëria dhe Maqedonia.

Buxheti Total i Programit: Totali i buxhetit të këtij programi është **39.727.654,00** Euro nga të cilat **€ 33.456.246,00** Euro janë fonde ERDF ndërsa **5.126.138,00** Euro janë fonde IPA (për Shqipërinë dhe Maqedoninë). Shuma e financimit të BE është 85% për gjithë prioritetet përveç Asistencës Teknike për të cilën është 75%.

Autoriteti Menaxhues dhe Kontraktues: Autoriteti Menaxhues Grek në varësi të Ministrisë Greke të Ekonomisë.

Sekretariati Teknik: ndodhet në qytetin e Selanikut ku ndodhen edhe zyrat e Autoritetit Menaxhues.

viii. PROGRAMI: INTERREG ADRION 2014-2020

Zonat e lejueshme: Në Program marrin pjesë 4 vende anëtare të BE (Italia, Greqia, Sllovenia dhe Kroacia) si edhe 4 vende kandidatë (Shqipëria, Bosnja, Mali i Zi, Serbia)

Buxheti Total i Programit: 99.1 Milion Euro nga të cilat alokime ERDF janë 83.4 Mln Euro dhe alokime IPA janë 15.7 Mln Euro. Aktualisht Komisioni Evropian po shqyrton mundësinë e rritjes së këtij alokimi dhe balancimin mes dy instrumentave (IPA dhe ERDF). Nënvizojmë se, Programi ADRION konsiderohet si instrumenti më i rëndësishëm financiar për zbatimin e projekteve që janë në sinergji me Strategjinë e BE për Adriatikun dhe Jonin (EUSAIR).

Autoriteti Menaxhues dhe Kontraktues: Rajoni i Emilia Romagna, Itali.

Sekretariati Teknik: ndodhet në qytetin e Bolonjas ku ndodhen edhe zyrat e Autoritetit Menaxhues.

Prioritetet e Programit:

- Mbrojtja e mjedisit dhe promovimin e adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike;
- Nxitja e transportit të qëndrueshëm dhe përmirësimin e infrastrukturës publike;
- Nxitje e konkurrencës, mjedisit të biznesit dhe zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, tregtisë dhe investimet;

Strategjia e BE-së për Rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR) është një strategji makro rajonale e miratuar nga Komisioni dhe Këshilli Evropian në vitin 2014. Strategjia u zhvillua bashkërisht nga Komisioni dhe vendet e rajonit Adriatiko-Jonian, të cilat ranë dakord të punojnë në fushat me interes të përbashkët për të mirën e secilit vend dhe të rajonit në përgjithësi.

EUSAIR mbulon tetë vende: katër shtete anëtare të BE-së (Kroaci, Greqi, Itali, Slloveni) dhe katër vende jo-anëtare të BE-së (Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Serbi). Objektivi i përgjithshëm i EUSAIR është promovimi i rritjes ekonomike dhe zhvillimit social në rajon duke përmirësuar bashkëpunimin, ndërlidhjen dhe konkurrueshmërinë midis vendeve.

Vendet pjesëmarrëse të EUSAIR ranë dakord për 4 fusha kryesore me interes të përbashkët dhe rëndësi të veçantë për rajonin Adriatiko-Jonian: **Zhvillimi Blu, Ndërlidhja e Rajonit, Cilësia e Mjedisit dhe Turizmi i Qëndrueshëm.**

Për të lehtësuar zbatimin e EUSAIR u financua **Projekti Strategjik Mbështetje për EUSAIR**, i cili ofron mbështetje operacionale për strukturat qeverisëse të EUSAIR.

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është lehtësimi i koordinimit dhe zbatimit të EUSAIR duke rritur kapacitetin institucional të administratave publike dhe aktorëve kryesorë, si dhe duke ndihmuar përparimin e zbatimit të prioritetëve të përbashkëta.

Projekti financohet nga Programi i Bashkëpunimit Transnacional Adriatiko-Jonian 2014-2020. Për funksionimin e tij, një shumë totale prej 11.5 milion euro është dedikuar për periudhën nga maji 2016 deri në dhjetor 2022.

Roli i partnerit kryesor i është besuar Zyrës së Qeverisë së Republikës së Sllovenisë për Zhvillim dhe Politikë Evropiane Kohezioni, e cila koordinon partnerët nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Greqia, Kroacia, Italia, Serbia dhe Sllovenia.

Projekti ofron mbështetje për:

Bordi Udhëheqës të EUSAIR (GB), si dhe 4 Grupet Drejtuese Tematike (TSGs), që përfshijnë tetë vende të rajonit Adriatiko-Jonian.

Më shumë informacion rreth projektit mund të gjendet në:
<https://eusairfacilitypoint.adrioninterreg.eu/>
Rreth EUSAIR: <http://www.adriatic-ionian.eu/>
Për Programin e Bashkëpunimit Transnacional Adriatik-Jonian 2014-2020
<http://www.adrioninterreg.eu/>